

NJOFTIM PËR SHPALLJEN E KONKURSIT KOMBËTAR “PËR PROCEDURAT E IDEIMIT, MODELIMIT DHE REALIZIMIT TË DEKORATAVE E TITUJVE TË NDERIT QË JEPEN NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS”.

Institucioni i Presidentit të Republikës, mbështetur në pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 112/2013 datë 04.04.2013, “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), si dhe V.K.M-së nr. 510 datë 18.07.2013, “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për veprat monumentale të artit pamor” (të ndryshuar):

1. Shpall konkursin kombëtar për procedurat e ideimit, modelimit dhe realizimit të dekoratave e titujve të nderit që jepen nga Presidenti i Republikës të renditura si më poshtë:

- Dekorata “**NDERI I KOMBIT**”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare, që me veprat dhe emrin e tyre, nderojnë kombin shqiptar brenda dhe jashtë vendit. (përmasat: diametri jo më i madh se 7 cm dhe as më i vogël se 4 cm; Pinat ose Spilat shoqeruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).
- Dekorata “**PISHTAR I DEMOKRACISË**”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për shërbime të shquara dhe sakrifica të kryera për kombin shqiptar dhe demokracinë. (përmasat: diametri jo më i madh se 6 cm dhe as më i vogël se 4 cm; Pinat ose Spilat shoqeruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).
- Titulli “**KALORËS I URDHRI TË SKËNDERBEUT**”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për akte të veçanta heroike në mbrojtjen, forcimin dhe përparimin e Republikës së Shqipërisë. (përmasat: diametri jo më i madh se 8 cm dhe as më i vogël se 7 cm; Pinat ose Spilat shoqeruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).
- Titulli “**KALORËS I URDHRI TË FLAMURIT**”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për veprimtarinë e tyre në dobi të shtetit dhe kombit shqiptar. (përmasat: diametri jo më i madh se 8 cm dhe as më i vogël se 7 cm; Pinat ose Spilat shoqeruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).
- Titulli “**MARTIR I DEMOKRACISË**”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja, që janë martirizuar për veprimtarinë e tyre të shquar për lirinë, demokracinë dhe përparimin shoqëror të Republikës së Shqipërisë (përmasat: diametri jo më i madh se 6 cm dhe as më i vogël se 5 cm; Pinat ose Spilat shoqëruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).
- Titulli “**MJESHTËR I MADH**”, i cili u jepet punonjësve të fushave të ndryshme të shkencës, artit, sportit, drejtimit, prodhimit dhe biznesit për punë të shquara dhe kontribut thelbësor në zhvillimin e sektorit. (përmasat: diametri jo më i madh se 6 cm dhe as më i vogël se 4 cm; Pinat ose Spilat shoqëruese me diametër nga 1.5 cm deri në 2 cm).

2. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs janë:

- 2/1.** Në konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë: artistë, studio grafike dhe subjekte të interesuara (fizikë apo juridikë) me kombësi shqiptare.
- 2/2.** Subjektet pjesëmarrës mund të paraqesin deri në 1 punim original, për secilin objekt si: dekoratat dhe titujt.
- 2/3.** Punimet duhet të jenë origjinale, të papublikuara dhe autori mban përgjegjësi ligjore për autencitetin e tyre.
- 2/4.** Ky konkurs nuk është i hapur për studentët.
- 2/5.** Në konkurs pranohen punime individuale dhe punime të realizuara në grup.
- 2/6.** Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të jetë shprehje artistike figurative grafike dhe shprehje artistike figurative e imazhit të dekoratës dhe titullit të nderit me prerje teknike për realizim. (dy punime artistike, një pamje figurative artistike + një pamje figurative e prerjes teknike të pamjes së dekoratës apo titullit të nderit).
- 2/7.** Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të paraqitet i punuar/printuar me ngjyra.
- 2/8.** Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të jetë i përmasave jo më të vogla se formati A3 (420 x 297 mm) dhe njëkohësisht duhet të jetë i shoqëruar me një CD e cila përmban punimin/punimet.
- 2/9.** Punimi duhet të jetë në paraqitje gjeometrike 3D (pamje ballore, pamje anësore dhe pamje nga mbrapa) si dhe e materializuar në teksturë gold.
- 2/10.** Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të paraqitet në shprehje artistike figurative grafike edhe në përmasën origjinale të dekoratës apo titullit të nderit.
- 2/11.** Pjesëmarrësit në konkurs krahas punimeve duhet të sjellin dhe CV e tyre profesionale.

3. Detyra e Projektimit për dekoratat dhe titujt e nderit duhet të jetë:

- Punimi (dekorata dhe tituj nderi) duhet të jetë shprehje artistike e simbolikës së identitetit kombëtar dhe e elementeve përkatëse sipas përmbajtjes së motivacionit të tyre. (paraqitja duhet të bëhet në dy përmasa, përmasa e parë në letër jo më e vogël se formati A3 (420 x 297 mm), përmasa e dytë duhet të jetë paraqitja e dekoratës dhe titullit të nderit në madhësinë origjinale dhe në CD, sipas përmasave të përcaktuara në pikën 1/b).
- Punimi (dekorata dhe tituj) duhet të jetë shprehje artistike figurative e imazhit të dekoratës dhe titullit të nderit me prerje teknike për realizim. Paraqitja e prerjes teknike duhet të bëhet në letër jo më e vogël se formati A3 (420 x 297 mm dhe ruhet në CD).

- Në CD vendosen të tre punimet: paraqitja si shprehje artistike në përmasën jo më e vogël se A3 për modelim, paraqitja si shprehje artistike në madhësi origjinale për modelim, paraqitja si prerje teknike për realizim.
- Paraqitja e lidhjes apo e kapjes së dekoratës dhe titullit të nderit si shprehje artistike figurative.
- Paraqitja e fjongos ku kapet ose lidhet dekorata apo titulli i nderit si shprehje artistike figurative.
- Përmasa e dekoratave (sipas përcaktimeve në pikën 1).
- Përmasa e titujve të nderit (sipas përcaktimeve në pikën 1).
- Vlerësimi artistik është:

1. Dekorata 150.000 Lekë
2. Titulli i nderit 150.000 Lekë

Sugjerim i simboleve kryesor të identitetit kombëtar (për dekorata dhe titujt) janë:

- Përkrenarja e Skënderbeut në profil dhe përballë
- Shqiponja e zezë e flamurit kombëtar
- Shpendi i shqiponjës
- Portreti i Skënderbeut përballë
- Portreti i Skënderbeut profil
- Titulli i shkruar i dekoratës apo titullit të nderit
- Gjethja e lisit, dushkut, ullirit, dafinës
- Motive tipike floreale gjithëpërfshirëse në kulturën shpirtërore dhe materiale të kombit shqiptar.
- Elemente dekorative dhe gjeometrike gjithëpërfshirëse në kulturën shpirtërore dhe materiale të kombit shqiptar.
- Elemente dekorative të punimeve të metalit dhe të veshjeve të mirënjohura në kulturën e kombit shqiptar (zbukurimi i armëve, gajtanëve dhe qëndisjet e veshjeve e të tjera).
- Ngjyrat si propozim janë : e bardhë, e zezë, e kuqe, e artë, e verdhë, e argjente, e gjelbërt.

4. Organizimi i Konkursit dhe Komisioni Përzgjedhës

- Institucioni i Presidentit të Republikës është institucioni ku do të organizohet konkursi.
- Konkursi shpallet më datë: 04.06.2018.
- Mbledhja e punimeve fillon nga data 05.07.2018 e deri më 06.07.2018.
- Dorëzimi dhe rregjistrimi i punimeve pjesëmarrëse bëhet pranë Institucionit të Presidentit të Republikës. Për çdo informacion mund t'i drejtoheni Institucionit të Presidentit të Republikës në numrin: 04 2389 872.
- Pas datës 06.07.2018 nuk pranohen punime për konkurim.

- Me përfundimin e konkursit dhe pas shpalljes së bocetit fitues, ndërmjet artistit/grupit të artistëve dhe Institucionit të Presidentit të Republikës lidhet një kontratë akt-marrëveshje për pagesën, kushtet e modelimit dhe realizimit të mëtejshëm të objekteve: dekorata dhe tituj nderi.
- Faza e realizimit të objekteve: dekorata dhe tituj nderi do të ndiqet nga një grup specialistësh dhe nga artisti fitues, me qëllim ruajtjen e cilësisë dhe saktësisë së imazheve fitues.
- Komisioni Përzgjedhës (juria) shqyrton punimet nga data 09.07.2018 deri më datë 15.07.2018.
- Më datë 15.07.2018 Komisioni Përzgjedhës (juria) do të përzgjedhë me sistem pikësh, nga 1 deri në 5, punimet më të mira për secilin objekt si: dekorata dhe titull nderi.
- Punimet më të vlerësuara nga Komisioni Përzgjedhës (juria) do t'i kalojnë për miratim përfundimtar Presidentit të Republikës.
- Pas miratimit nga Presidenti i Republikës bëhet shpallja e fituesit.
- Komisioni Përzgjedhës i konkursit përbëhet nga 5 anëtarë, personalitete nga fusha e historisë, artit dhe kulturës, miratuar nga titullari Institucionit të Presidentit të Republikës ose personit të autorizuar prej tij.
- Komisioni Përzgjedhës i konkursit miraton në ditën e tij të parë rregulloren e funksionimit të konkursit.
- Për secilin objekt do të jepet vetëm një çmim i parë.
- Nga shuma e vlerësimit artistik do të mbahet tatimi prej 15%.
- Punimet fituese bëhen pronë e arkivës së Institucionit të Presidentit të Republikës.
- Punimet jofituese duhet të tërhiqen deri më datë 30.07.2018. Pas kësaj date këto punime asgjësohen.
- Në bazë të nenit 9, pika c të ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” (i ndryshuar), nuk i njihet e drejta e përfitimit material të mëtejshëm për përdorimin e veprës së tij nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës”.
 - Nga data 04.06.2018 me shpalljen publike të konkursit, të gjithë të interesuarit mund të informohen me materialin e shkruar, si dhe nëpërmjet ëbsit-it www.president.al .